



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 98 prot.

Kamëz, më 26.07.2024

V E N D I M

Nr. 75 .Datë 26/07/2024

MBI

“DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 43, DATË 18.11.2019, TË KËSHILLIT BASHKIAK” PËR ORGANIZIMIN E VEND PARKIMEVE TË TRANSPORTIT TAKSI 4+1 NË TË GJITHË TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 26.07.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.52 Datë 19.07.2024 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 8308, date 18.03.1998 “ Për Transportet Rrugore” i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë pasi shqyrtoi Relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Transportit, Lejeve dhe Liçensave, i propozon Këshillit Bashkiak të miratojë Projekt Vendimin “ Për Disa Shtesa në Vendimin Nr.43,datë 18.11.2019, të Këshillit Bashkiak ”Për organizimin dhe përcaktimin e vend parkimeve të Transportit Taksi 4+1 në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz”, **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e Vendimit Nr.43,datë 18.11.2019, të Këshillit Bashkiak“ Për organizimin dhe përcaktimin e vend parkimeve të Transportit Taksi 4+1 në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz”, të bëhen disa shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 1, të shtohen 4 vende parkimi në “Rrugën Skënderbeu”, Kamëz.
2. Në pikën 2, të shtohen 4 vende parkimi në Rrugën “Berisha”, Kamëz.
3. Në pikën 3, të shtohen 8 vende parkimi në Rrugën “Demokracia”, Bathore.
4. Në pikën 4, të shtohen 2 vende parkimi në Rrugën “Donald Trump”,Kamëz.

Si dhe të shtohen këto vende parkimi të tjera në këto rrugë, si më poshtë:

1. Të shtohen 4 vende parkimi në Rrugën “Azem Galica”, Babrru.
2. Të shtohen 4 vende parkimi në Bulevardin “Nene Tereza”, Kamez.

Bashkëlidhur, Relacioni shpjegues i Vendimit dhe hartat përkatëse me shtesat e propozuara për secilën Rrugë me vendndodhjen e saktë dhe përcaktimi i numrit të vend parkimeve Taksi 4+1.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI